



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010 dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Kryeqytetit,

th ë r r e t

mbledhjen e **pestë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **29.5.2025** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Kryeqytetit.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Propozim-vendimi për Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026;
2. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
3. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
4. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme MPB-së – Policisë së Kosovës;
5. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Këshillit Prokurorial të Kosovës;
6. Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve;
7. Propozim-vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;

- KUVENDI I KRYEQYTETIT**
01-060/01-69229/25, më 19.5.2025

Fehmi Kupina